



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.287/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR për shkak të materialit zgjedhor afër qendrës së votimit në komunën e Vushtrrisë, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr 287/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA**

## A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA në të cilën thekson se në afërsi të shkollës “Lutfi Musiqi” në qytetin e Vushtrrisë, në afërsi prej 70-80 metrave kanë qenë të vendosur posterat e kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit LDK-AKR. Sipas parashtruesit të ankesës kjo është shkelje e nenit 36 pika a e LZP-së lidhur me këtë shkelje si dëshmi ka bashkangjitur një CD nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar:**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë te qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Sepse nga CD e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është shkolla “Lutfi Musiqi” në qytetin e Vushtrrisë,” dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për te votuar si Qendër e Votimit, në ditën e votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr. 287/2017 më datën 13.06.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi

***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*

